



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:161271
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05486771

P.nr. 104/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Z. S. I., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.806/2023 të dt. 25.07.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.19.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari Z. I. si dhe përfaqësuesja e te dëmtuarës KEDS Arjana Mula, me dt. 20.03.2024, shpallë, ndërsa me dt.21.03.2024, e përpilon këtë:

AKTGJYKIM

I AKUZUARI: Z.I., nga i ati S. dhe e ëma M. e lindjes G., i lindur më datën ..., në fshatin Ll., Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar, i ati i 6 (katër) fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Nga data e pavërtetuar e gjer me date 11.08.2022, në shtëpinë e tij ne fshatin Ll., Komuna Malishevë, i pandehuri me anë te lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për te cilat dihet se mundësohen vetëm ne shkëmbim te kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime te tilla, si shfrytëzues i njehsorit me shifër DGJ ..., ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike te Kosovës, ne atë mënyre qe ditën kritike nga kontrolli i zyrtarëve te K. është konstatuar se njehsori smart ka qen i shkyçur nga AMR-ja mirëpo i pandehuri ka kyçur një kabllo 5x6 mm direkt ne rrjetin elektrik jashtë pikës matëse ku ne këtë mënyre energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me q 'rast te dëmtuarës K.-sh.a Distribucioni ne Gj., i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 221.89 euro.

- me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë, të njëjtin e:

G J Y K O N

Ashtu që ia shqipton dënimin me kusht në kohëzgjatje prej **5 (pesë)** muajve burgim, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gj. që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gj..

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 20 euro, në emër të viktimave të krimit shumën prej 20 euro, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

E dëmtuara K.- distrikti në G., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.806/2023 të dt. 25.07.2023, e ka akuzuar Z. I., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 19.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari Z. I. si dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës KEDS Arjana Mula, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari Z. I., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilin jam penduar, mirëpo për shkak të kushteve shume të vështira ekonomike, unë nuk kam kurrfarë burimi për ekzistencë, të vetmin burim e kam një pension të pleqërisë, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësues me rastin e shqyrtimit të dënimit të me shqiptoj një dënim me të bute, i premtoj gjykatës që ne të ardhmen do të jem me i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Përfaqësuesja e te dëmtuarës KEDS, Arjana Mula, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i bashkangjitem ndjekjes penale dhe parashtroj kërkesë pasurore juridike.

Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj deklaron: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari pasi që ky pranim i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare, pa presion duke i ditur pasojat dhe benefitet e një pranimi te tille. Si rrethane lehtësues me rastin e shqiptimit te llojit dhe lartësisë se dënimit propozoj gjykatës që te ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale te kryer, kërkim faljen. Ndërsa si rrethana renduese gjykata duhet ti ketë parasysh faktin se i njëjti është recidivist i kësaj natyre te veprës penale, andaj propozoj që i njëjti te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit si dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari Z.I. ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike i dt. 09.04.2022;
- Kalkulimi i rikthimit te humbjeve te dt. 05.05.2022;
- Fatura mbi demin e shkaktuar D. te dt. 05.05.2022
- Foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera ne lende.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314, par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së parashihet: „ Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”, si dhe „Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar”.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Z. I., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, është i ati i 6 fëmijëve dhe i gjendjes së dobët ekonomike, mban familjen me një pension te pleqërisë, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, andaj duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi udhëzimin në kontestin civil

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449, par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39, parg.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.104, dt.20.03.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.